

KODI I SJELLJES

SË GRANTMARRËSIT E PARTNERËVE QË ZBATOJNË GRANTE ME MBËSHTETJEN E LEVIZALBANIA

Ky Kod i Sjelljes është i zbatueshëm nga **të gjithë grantmarrësit dhe partnerët e tyre**, të cilët hyjnë në një marrëdhënie kontraktuale për dhënie granti me projektin LevizAlbania (LA). Kodi i Sjelljes nënshkruhet nga Grantmarrësit dhe partnerët e tyre dhe bëhet pjesë e Kontratës së Grantit.

Kodi i Sjelljes rrjedh nga vlerat e përbashkëta të përcaktuara në identitetin e Projektit. Për të zbatuar sa më mirë këtë kod, ne anëtarët/punonjësit e Projektit të Grantit të mbështetur nga LevizAlbania, i ushtrojmë këto parime për veten dhe për nënkontraktorët/partnerët me të cilët do të bashkëpunojmë. Kjo është dëshira jonë që partnerët tanë të projektit dhe grupet e synuara të respektojnë parimet tona.

Të drejta të barabarta

Në punën tonë me njerëz të tjerë, ne nuk bëjmë dallim në lidhje me gjininë, ngjyrën e lëkurës, përkatësinë fetare, kulturën, arsimin, statusit social apo kombësisë. Ne përmbushim angazhimet tona kontraktuale, në respektim të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore.

Transparenca

Ne, jemi të sigurt se veprimtaria dhe motivet tona janë të arsyetuara dhe të kuptueshme.

Konfidencialiteti

Informacioni i marrë do të trajtohet në fshehtësi, në rastet kur kjo kërkohet edhe shprehimisht apo kuptohet nga natyra e informacionit.

Bashkëpunimi me bazë Partneritetin

Ne së bashku me partnerët tanë, grupet e synuara dhe kolegët punojmë në mënyrë të drejtë dhe të besueshme, në bazë të besimit të ndërsjellë dhe duke mbajtur një qasje konstruktive për menaxhimin e konfliktit.

Trajtimi i konfliktin e interesit

Në punën tonë, konfliktet mund të lindin në mes interesave tona personale, dhe interesave të partnerëve tanë apo dhe grupeve të synuara. Ne, menjëherë japim informacionin shpjegues për konflikte të tilla tek LA, si dhe përpiqemi t'i japim zgjidhje në atë mënyrë, që është objektivist e verifikueshme dhe e kuptueshme për të gjitha palët e përfshira. Ne kujdesemi mjaftueshem për të ndarë sferën private nga ajo e biznesit.

Ne i përmbahemi këtyre rregullave:

Ryshfeti/Mitmarrja aktive dhe passive

Nuk lejohet të kërkohet, pranohet, ofrohet apo jepet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, rryshfet në para, dhurata apo favore.

Zbatohen rregulla të veçanta për pranimin e dhuratave dhe përfitimeve të tjera personale, si dhe për ofrimin e dhuratave dhe favoreve tjera. Bashkëpunëtorët tanë dhe nënkontraktorë të tjerë marrin pagesën e duhur për furnizimet dhe shërbimet që ata japin. Ne nuk paguajmë asnjë para në formë rryshfeti për t'ju kaluar palëve të treta.

Pranimi i dhuratave, rryshfetit apo përfitimeve të tjera

Pranimi i dhuratave apo përfitimeve të tjera personale nga partnerët, dhënësit e shërbimeve dhe grupet e synuara është i ndaluar, përveç rasteve kur këto janë dhurata të vogla apo simbole me vlerë të ulët dhe kur eprori ka dhënë pëlqimin e tij/saj me shkrim. Eprori mund të japë pëlqimin e tij/saj për të pranuar dhurata dhe avantazhe të tjera, në raste përjashtuese, kur pranimi është konsideruar një gjest mirësjelljeje.

Në shumë raste, pranimi dhe ofrimi i dhuratave dhe përfitimeve të tjera përbën vepër penale apo korrupsion. Për të gjitha ngjarjet, përveç aspektit penal, edhe ndonjë paraqitje kur marrësi është në një pozitë detyrimi jo legjitim duhet të shmanget.

Për rregullat mbi pranimin dhe dhënien e dhuratave dhe përfitimeve të tjera personale duhet te jepni informacion për dallimin midis veprimeve të lejueshme dhe të papranueshme apo penale.

Përfitimet nuk përfshijnë vetëm dhuratat, por të gjitha shërbimet për të cilat anëtarët e stafit nuk kanë drejtë t'i marrin; është fjala për ato, të cilat mund të përmirësojnë statusin e tyre në terma ekonomike, ligjore apo personale. Këto përfshijnë, p.sh. dhënie falas apo ulje e çmimit të biletës së udhëtimit, përdorimi i automjeteve, bileta hyrje/dalje dhe zvogëlime të favorshme, në masën që këto nuk janë dhënë shprehimisht për të gjithë stafin në bazë të marrëveshjeve kontraktuale; kompensim për shpenzimet e udhëtimit, ftesa për darkë, përfundim të marrëveshjeve të konsulencës etj. Marrja e përfitimeve mund të thuhet se ekziston kur përfitimet janë dhënë edhe për një "palë të tretë" (bashkëshortin/partnerin, fëmijët etj).

Dhurata të vogla

Përbëjnë dhurata të rastit dhe përfitime të tjera, dhuratat apo simbolikat e vogla, vlera e të cilave për dhënësit, për vit kalendarik dhe punonjes të zyres/projektit nuk kalon 35 euro.

Ftesat për drekë/darkë nga partnerët konsiderohen si dhurata të vogla - edhe nëse ato kalojnë kufirin prej 35 € - me kusht që të zhvillohen në një kuadër të përshtatshëm dhe standard të bashkëpunimit. Për arsye të transparencës, punonjesit duhet të informojnë eprorin e tyre në qoftë se ata marrin ftesa të shpeshta për darkë ose nëse PNDV-ja shpesh merr përsipër shpenzimet e ngrënies në të tilla raste.

Konflikti i interesave, lidhjet personale dhe financiare

Nëse një punonjes i projektit ka lidhje personale, familjare, financiare, apo të çdo natyre tjetër, me partnerë të projektit, të cilët mund të çënojnë objektivitetin e vendim-marrjes apo marrëveshjet brenda objektit të punës, atëherë duhet të informohet eprori në projekt si dhe LA, në mënyrë që të mund të merret një vendim mbi hapat e mëtejshme të nevojshëm.

Nëse synohet lidhja e një kontrate (kontratë pune, kontrata për shërbime të pavarur, etj.) me persona me lidhje të afërta me personat e angazhuar në projekt, duhet të informohet eprori i projektit dhe LA për marrjen e një vendimi të arsyeshëm.

Anëtarët e Projektit, të cilët japin kontrata, nuk janë të lejuar të kene marrëdhënie private biznesi me nënkontraktorët e angazhuar. Në raste përjashtuese, shërbimet e nënkontraktorëve mund të hartohen për qëllimet private nëse këto shërbime janë në dispozicion për të gjithë.

Si rregull, objektiviteti i një punonjesi për qëllim të punës së tij/saj rrezikohet kur, për shembull, ai/ajo vendos/jep urdhëra në emër të projektit për të afërmit apo kompanitë në të cilat anëtari i personelit apo persona të lidhur të tij/saj janë të përfshirë. Personat e lidhur të tij/saj janë të përcaktuar si: i/e fejuari/a, bashkëshorti, bashkëjetuesi, të afërmit, dhe në aktet nënligjore në vijë të drejtë, vëllezërit e motrat, fëmijët, vëllezërve e motrave, vëllezërit e motrat e bashkëshortes/ve dhe personave që kanë bashkëjetuar, vëllezërit e motrat e prindërve, dhe kujdestarët e prindërve dhe fëmijëve.

Rastet e dyshimit:

Në rastet e dyshimit, punonjesisit duhet të konsultohen me eprorin e tyre i cili më pas duhet të marrë një vendim lidhur me çështjen. Nëse eprori nuk është i sigurt në lidhje me vendimin e duhur në një rast të caktuar, ai/ajo duhet të konsultohet me eprorit e tij/saj dhe/ose me këshilltarin e duhur.

Detyrimi për shmangien e shkeljeve dhe për raportimin e shkeljeve

Grantmarrësit dhe partnerët kanë ka detyrimin që gjatë zbatimit të grantit, të shmangin çdo lloj veprimi, i cili bie ndesh me parimet e demokracisë. Grantmarrësit dhe partnerët kanë në asnjë rast nuk do të përdorin emrin e Grantdhënësit, konsorciumit apo donatorit, në mënyrë të papërshtatshme apo të kundraligjshme. Grantmarrësit dhe partnerët kanë detyrimin që të raportojnë tek Grantdhënësi për veprime me karakter korruptiv, abuziv apo shpërdorues, që ndodhin në kuadër të projektit në zbatim.

Grantmarrësi dhe partneri/partnerët raportojnë parregullsitë tek Ambasada e Zvicrës në Shqipëri (tirana@eda.admin.ch) dhe më pas në Zyrën e Përputhshmërisë të SDC (Compliance Office) në adresën compliance@eda.admin.ch

Rregullimet e mësipërme janë njësoj të vlefshme për çdo anëtar të Grantmarrësve dhe Partnerëve, apo çdo person tjetër, të angazhuar me ta, në kuadër të zbatimit të grantit, përmes një marrëdhënie pune, biznesi apo çdo lloj marrëdhënie tjetër.